Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1166

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Batisha Ibrahimi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE "TEHNOBURIMI" D.D., si dhe OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., kundër, vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA" me numër të prokurimit 207-24-8717-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK", më 10/02/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohen, si të pabazuara ankesat e "TEHNOBURIMI" D.D., me nr.2024/1166, e datës 02/12/2024 si dhe OE ankues "NIKA PrO- Ing" SH.P.K. me nr.2024/1167 me nr., 02/12/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA'", me numër të prokurimit 207-24-8717-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –, "MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK".

2. Mbetet ne fuqi vendimi i AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA'", me numër të prokurimit 207-24-8717-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –, "MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK".

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorëve ekonomik ankues "TEHNOBURIMI" D.D si dhe "NIKA PrO- Ing" SH.P.K i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.08.2024, "MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA" me numër të prokurimit 207-24-8717-5-1-1. Ndërsa me datën 11.11.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit te prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës pune, vlera e parashikuar e kontratës: 4,000,000.00 €.

Me 18.11.2024, OE "TEHNOBURIMI" D.D dhe OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K me datën 18.11.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 20.11.2024, e ka refuzuar si te pa bazuara kërkesat për rishqyrtim te të dy OE.

Me 02.12.2024, OSHP ka pranuar ankesat nga OE "TEHNOBURIMI" D.D me nr. 2024/1166 dhe ankesën e OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K me nr.2024/1167 me datën 02.12.2024 lidhur me aktivitetin "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA" me numër të prokurimit 207-24-8717-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 1166/24 dhe ankesa nr. 1167/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "TEHNOBURIMI" D.D për ankesën me nr.2024/1166 janë parashtruar si në vijim:

Njoftimi mbi vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit përkatësisht formulari B 58 është ngritur në sistem me dt. 11.11.2024.

Anulimi i këtij tenderi është bërë me dt. 11.11.2024 me arsyetimin si më poshtë:

Rezultati i aktivitetit te prokurimit: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit-, bazuar në nenin 43.5 të Rregullores nr. 001/ 2022 për prokurimin Publik anulon aktivitetin e prokurimit një titull: Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpik, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA', pasiqë asnjë prej ofërtave lë pranuara nuk është i përgjegjshëm që i plotëson kushtet dhe kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Te pa kënaqur me njoftimin mbi vendimin e AK te dt. 11.11.2024 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA' me Nr. te prokurimit: 207-24-8717-5-1-1 ne afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila kërkesë ishte refuzuar nga AK-së.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj na ka eliminuar me arsyetimin si në vijim: Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vepruar në përputhje me nenin 44.3 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik, ku oferta e tillë është konsideruar ofertë e papërgjegjshme pasi që OE "TEHNOBURIMI " D.D., ka paraqitur çmimin e përgjithshëm duke e larguar pjesën e TVSH- së të cilën e ka paraqitur AK- MKRS në para masë dhe si e tillë nga AK- MKRS është vlerësuar ndërhyrje ne para masë andaj oferta është ofertë administrativisht e papërgjegjshme.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm, sepse ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, andaj në vijim do të sqarojmë se arsyeja e eliminimit tonë është e paqëndrueshme.

Për të qenë më të qartë në lidhje me ofertën tonë, po e sqarojmë në detaje ofertën financiare më të cilën kemi ofertuar sipas paramasës:

Faktikisht nga paramasa janë larguar gabimisht dy kolona në fund e të cilat kolona nuk kanë pas të vendosura as sasi e as njësi, prandaj ky lëshim teknik nuk përbën ndonjë ndërhyrje në paramasë siç është quajtur nga autoriteti kontraktues.

Ne gjatë plotësimit të paramasës tek çmimi për njësi kemi dhënë çmimet me TVSH e poashtu edhe tek rekapitullimi i kemi vendosur çmimet për secilin pozicion me TVSH dhe njëkohësisht edhe totali i vendosur tek kolona "Gjithsejtë", është totali i ofertës tonë me TVSH 3,812,122.92 euro.

Gjithashtu ky fakt vërtetohet edhe nga procesverbali i hapjes së tenderëve, ku çmimi ynë pa TVSH është 3,230,612.64 euro, ndërsa çmimi me TVSH është 3,812,122.92 euro, andaj nga ky fakt kuptohet se ne e kemi plotësuar paramasën në mënyrë të rregullt dhe në të janë të vendosura secili nga pozicionet të cilat janë përcaktuar nga ana e AK-së. Pra me një fjalë ne nuk kemi bërë ndonjë ndryshim në paramasë, mirëpo për shkak të një lëshimi teknik është larguar kolona TVSH dhe totali me TVSH, mirëpo ky fakt nuk e bënë të papërgjegjshme ofertën tonë dhe nuk krijon asnjë dilemë sa i përket çmimit të ofruar me TVSH sepse ky çmim mund të vërtetohet shumë lehtë se është çmim me TVSH.

"Autoriteti Kontraktues, ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit, ne mesin e kërkesave dhe kushteve për plotësim dhe respektim nga OE-te, ka kërkuar qe çmimi i ofertuar për njësi dhe atë te totalit te pozicioneve te jene te plotësuara me apo pa TVSH te përfshirë pasi qe nuk ka përcaktuar se shuma apo totali i pozicioneve te jetë me apo TVSH. (provë tabela'

Ndërsa tek totali i ri- kapitullimit është cekur gjithsejtë prapë duke mos specifikuar se me apo TVSH, gjë që është dashur te ceket Gjithsejtë pa TVSH + TVSH (18%) dhe totali me TVSH siç është cekur (provë tabela Excel ri - kapitullimi)'.

Nga kjo situatë e krijuar duke qenë se autoriteti kontraktues ka lënë te hapura të gjitha fushat në Excel ne kemi plotësuar të gjitha pozicionet, totalin e pozicioneve si dhe ri – kapitullimin e paramasës duke e përfshirë edhe TVSH-në, kjo dëshmohet edhe sipas procesverbalit të hapjes, formularit të tenderit si dhe sistemit elektronik E-prokurimi ne shumë totale 3,812,122.92 euro me TVSH e cila përputhet me para masën - ofertën financiare.

Shih më poshtë procesverbalin e hapjes së ofertave, ku vërehet çmimi pa TVSH dhe çmimi me TVSH.

Ky veprim i yni duhet dhe është dashur të konsiderohet nga autoriteti kontraktues si devijim i vogël, konform dispozitave të nenit 59.4 të LPP-së pika (ii), ku specifikohet si në vijim: l. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pra, përderisa në ofertën tonë është i qartë dhe i kuptueshëm çmimi me TVSH dhe pa TVSH, atëherë oferta jonë është e përgjegjshme, andaj edhe arsyeja e autoritetit kontraktues për eliminimin tonë është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar, sepse ndryshimi i bërë në paramasë nuk ndikon fare në këtë aktivitet të prokurimit, pra nuk është ndryshim material e as substancial që mund të shkaktonte ndonjë devijim nga karakteristikat dhe kërkesat e dosjes së tenderit, prandaj

konsiderohet devijim i vogël sipas dispozitës së nenit 59.4 të LPP-së pika (ii).Realisht nuk mund të quhet as ndryshim i paramasës largimi i dy kolonave nga paramasa por thjesht është iëshim teknik dhe lëshim i papërfillshëm.

Çmimi në paramasë përputhet edhe me çmimin tek formulari i tenderit (shih më poshtë), prandaj nuk ka asnjë dilemë në këtë rast. 1Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'VVorld Aquatics FINA'

3.Çmimi total i tenderit është: 3,812,122.92 EUR Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4.Ky tender është vahd për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim te tenderëve.

Gjithashtu nëse autoriteti kontraktues ka pasur ndonjë paqartësi në lidhje me ofertën tonë, atëherë e njëjta është dashur ti shfrytëzoj dispozitat ligjore të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe të na kërkoj sqarime shtesë, edhe pse çmimet kanë qenë të qarta. Paragrafi 2 i nenit 59 të LPP-së e përcakton qartë "2.Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. "

Pra sqarime mund të kërkohen mbi cilin do aspekt të tenderit, e që edhe në këtë rast kanë mundur lehtë të kërkohen sqarime shtesë.

Referimi i AK-së tek neni 44.3 i RRPP Nr.001/2022 është i pasaktë dhe realisht rasti jonë nuk ka të bëjë fare me këtë dispozitë sepse kjo dispozitë përcakton qëllimin e dokumenteve standarde për ti ndihmuar operatorët ekonomik, ndërsa në këtë rast nuk ka fshirje të ndonjë kushti të përcaktuar në dosje të tenderit apo në paramasë, prandaj veprimi i ynë nuk bie në kundërshtim me këtë dispozitë.

Esenca është që çmimi në ofertë është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj arsyeja e eliminimit është e pa bazuar.

Në këtë aktivitete prokurimit vetëm grupi i OE "Olti Trasing SHPK&SINANI-ING SHPK, janë me çmim më të lirë mirëpo ky grup është i papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë (arsye të dhëna edhe nga AK-së): ARSYETIM Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Pas vlerësimit të ofertës tuaj nga komisioni i vlerësimit është vërejtur te oferta e GOE mungon dëshmia Deklarata e pjesëmarrjes së Grupit të Operatoreve Ekonomik konkretisht GOE nuk e ka plotësuar pikën b) të paragrafit 11.1 të Dosjes së Tenderit. Po ashtu, në ofertën e GOE ka ofruar si dëshmi mbështetjen bankare që nuk është sipas kërkesës së AK.

Kërkesa e AK ishte, citat: "Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 2.- Një falje vërtetim nga një Bankë e kasës së parë, i cili dëshmon se Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, disponon me mjete të gatshme në llogarinë bankare, në shumën prej 600,000.00 € [Gjashtëqind mijë euro. [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi fleader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë - Një [1 kopje e origjinalit. OSE Një [1J vërtetim nga një Bankë e kasës së parë, i cili dëshmon se Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, disponon me qasje në një kredi bankare të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, në shumen prej 600,000.00 € [Gjashtëqind mijë euroja. JNë rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi fleader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë - Një JIJ kopje e origjinalit.

Ndërsa, GOE ka ofruar një Letër Referencë nga institucioni bankar që nuk dëshmon që GOE ka një të gatshme në llogari i apo qasje në kredi të pakushtëzuar mirëpo Letër Referenca e paraqitur dëshminë se institucioni bankar do të shqyrtojë mundësinë e financimit të projektit të sipërpërmendur. Vërejtje: Nuk janë kërkuar informacion shtesë, pasi që nuk ishit ofert i të administrativisht c përgjegjshme një çmimin me të lirë!

Duke pasur parasysh që ky grup i OE është i papërgjegjshëm, atëherë ne jemi ofertuesi më i lirë në krahasim me ofertuesit tjerë dhe jemi poashtu të përgjegjshëm duke i plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e kualifikueshmrëisë e ka konstatuar edhe komisioni vlerësues, por që të vetmen arsye e kanë dhënë çështjen e paramasës e cila realisht është lëshim teknik dhe devijim i vogël i cili absolutisht ndikon në përgjegjshmërinë tonë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se ne jemi eliminuar me një arsye të pa bazuar, pasi që edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, po eliminohemi në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.20.11.2024, ku autoriteti kontraktues nuk ka mundur të arsyetojë në asnjë mënyrë eliminimin tonë.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj e ka përsëritur arsyen e njëjtë sikurse me rastin e eliminimit tonë, mirëpo ne edhe një herë po e sqarojmë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i paqëndrueshëm për faktin se nga paramasa janë larguar gabimisht dy kolona në fund e të cilat kolona nuk kanë pas të vendosura as sasi e as njësi, prandaj ky lëshim teknik nuk përbën ndonjë ndërhyrje në paramasë siç është quajtur nga autoriteti kontraktues.

Ne gjatë plotësimit të paramasës tek çmimi për njësi kemi dhënë çmimet me TVSH e poashtu edhe tek rekapitullimi i kemi vendosur çmimet për secilin pozicion me TVSH dhe njëkohësisht edhe totali i vendosur tek kolona "Gjithsejtë", është totali i ofertës tonë me TVSH 3,812,122.92 euro. Gjithashtu ky fakt vërtetohet edhe nga procesverbali i hapjes së tenderëve, ku çmimi ynë pa TVSH është 3,230,612.64 euro, ndërsa çmimi me TVSH është 3,812,122.92 euro, andaj nga ky

fakt kuptohet se ne e kemi plotësuar paramasën në mënyrë të rregullt dhe në të janë të vendosura secili nga pozicionet të cilat janë përcaktuar nga ana e AK-së. Pra me një fjalë ne nuk kemi bërë ndonjë ndryshim në paramasë, mirëpo për shkak të një lëshimi teknik është larguar kolona TVSH dhe totali me TVSH, mirëpo ky fakt nuk e bënë të papërgjegjshme ofertën tonë dhe nuk krijon asnjë dilemë sa i përket çmimit të ofruar me TVSH sepse ky çmim mund të vërtetohet shumë lehtë se është çmim me TVSH.

Andaj nga të gjitha të lartcekurat, kuptohet qartë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit dhe vendimi i saj për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim janë të paqëndrueshme.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe me nenin 43 të RRPP Nr.001/2022, sepse ne nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita, kurse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe është dashur te shpallemi fitues i këtij tenderi.

Gjithashtu nuk e është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE i përgjegjshëm sepse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE "TEHNOBURIMI" D.D konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 62, dhe 72 te LPP-së si dhe rregullores 001/2022 për prokurim publik nenin 40 dhe 43. Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që te merrni: VENDIM Te APROVOHET, e bazuar ankesa e OE "TEHNOBURIMI DD" SH.A Dhe te ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: "TEHNOBURIMI" D.D., Përgjigje mbi pretendimin 1 : Pretendimi është i PABAZUAR

Autoriteti Kontraktues- MKRS ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin c tenderëve në harmoni të plotë me nenin 59 të Ligjit nr. 04/ 1 -042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr,. 04/ L- 237, Ligjin nr. 05/ L- 068 dhe Ligjin nr. 05/ L- 092.

Sa i përket pretendimit me nr. 1 të GOE ankues, AK sqaron se është tërësisht i pabazuar sepse AK ka vlerësuar duke u bazuar mbi faktet dhe argumentet e prezantuara në ofertën e ankuesit. GOE ankues nuk është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për shkak se ka gabuar vlerën e llogaritur të TVSH- së por është konsideruar ofertë e papërgjegjshme për arsye se ka ndërhyre në paramasë duke e larguar komplet pozicionin e TVSH- së të paraqitur nga AK në paramasën kryesore.

Në paramasë nga AK është paraqitur forma si në vijim: Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me nenin 44.3 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik, ku oferta e tillë është konsideruar ofertë e papërgjegjshme pasi që OE " TEHNOBURTMI " D.D., ka paraqitur çmimin c përgjithshëm duke e larguar pjesën e TVSH- së të cilën e ka paraqitur AK- MKRS në para masë dhe si e tillë nga AK-MKRS është vlerësuar ndërhyrje ne para masë andaj oferta është ofertë administrativisht e papërgjegjshme. Sqarim/Duke marrë parasysh se ka vendime të OSHP-së lidhur me trajtimin e kësaj qështje ndërhyrje në paramas një gjë e tillë në bazë LPP-së është ofertë e papërgjegjshme. Prandaj, pretendimi është në tërësi i pabazuar.

Si përfundim, Autoriteti Kontraktues qëndron prapa arsyeve të eliminimit te të gjithë anëtareve për eliminim duke lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit sipas dispozitës "Anulohet procedura e prokurimit duke u mbështctur në nenin 43.5 lë Rregullores 001/2022, pika b, duke specifikuar: 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm".

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “NIKA PrO- Ing” SH.P.K për ankesën me nr.2024/1167 janë parashtruar si në vijim:

Me datën 11,11,2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku e keni anuluar këtë AP, Pas kërkesë për qasje ne dokumentet e OE pjesëmarrës, Ju si AK, nuk na keni ofruar te gjitha dokumentet e njërit nga OE pjesëmarrës me arsyetim se i njëjti ka Deklaratën për Sekret Afarist, Ne deklaratën e Aneksit 3 te Dosjes se Tenderit, vërehet se ky Grup i OE nuk ka specifikuar as një kërkesë për sekret afarist, mirëpo vetëm e ka vulos dhe nënshkrua një deklaratë bllanko nga Dosja c Tenderit.-Ky nuk është një pretendim ankimor, mirëpo vetëm një sqarim ne hyrje të kërkesës për rishqyrtim, Arsyeja e eliminimit tonë nuk qëndron me pretendimin se:

Pretendimet tona janë si ne vijim: Nuk pajtohem me konstatimin c juaj për eliminimin ton dhe anulimin e kësaj procedurë te prokurimit.

Nuk pajtohem me anulimin e këtij aktiviteti duke marr parasysh që oferta jon është ofertë e përgjegjshme.

Gjithashtu nuk pajtohemi me eliminimi ton, pasi që ju keni ber keqinterpretim te dokumentacionit ton ne Vlerësimin c atyre nga Komisioni i vlerësimit, Ne kërkesën tuaj ne Dosjen c Tenderit te Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, Përshtatshmëria profesional: siç janë Citoj kërkesën “ Kërkesa numër I. Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik. Kërkesa numër 2. Operatori Ekonomik duhaçit ta paraqes edhe dokumentin për regjistrim të

TVSH-së. Kushte specifika - Vetëm kategoria e Operatoreve ekonomikë Grupeve të operatorëve ekonomik me aktivitete ekonomike, sipas klasifikimit të përcaktuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës [ARBK|, të përqendruar në fushën e projektimit të arkitekturës dhe inxhinierisë si dhe të ndërtimit, janë të pranueshëm përshtatshëm për pjesëmarrje në këtë procedurë; përkatësisht, të gjitha kategoritë tjera të Operatorëve ekonomike Grupeve të operatoreve ekonomik, nuk janë të pranueshëm përshtatshëm për pjesëmarrje dhe çfarëdo kontributi, në këtë procedurë. - Ekzekutimi i shërbimeve është i rezervuar për ketë kategori të Operatoreve ekonomik Grupeve të operatorë ekonomik në përputhje me Nenin 7- Barazia në trajtim Jo-Diskriminimi të Ligjit nr. 04 L-042 për prokurimin publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04 L-237, Ligjin Nr. 05 L-068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092." Mbyll citatin.

Ju keni ber vlerësimin e ofertës sonë ne kundërshtim me këtë kërkesë. Elaborat: oferta jon për këtë Aktivitet te prokurimit, ka qen nga Grupi i OE, ku ne përbërjen e grupit është një kompani e regjistruar jashtë territorit te Republikës se Kosovës, ne vendin e tyre te themelimit kriteret e përcaktimit te bërjes biznes, jo detyrimisht janë te njëjta me sistemin ton të brendshëm oshça me saktë sipas rregullave te ARBK-se, (Partneri ynë është një kompani me renome ndërkombëtare ne fushën e projektimit të arkitekturës dhe inxhinierisë si dhe të ndërtimit, Specifikasht keni te bashkangjitur kontratat dhe liku-n, ku shihet se te njëjtit kanë ndërtuar një kompleks të terin turistik ne resorin me te famshëm ne Rivierën Greke dhe ku ka të përfshira edhe Pishina te I hapura dhe Pishina te mbuluara, SPA etj, Spitale te nivelit Botëror, I lotele me standarde me te larta të ndërtimit dhe funksionalizimit dhe Metro. dhe është e pa pranueshme që të ceket se te njëjtit nuk kanë veprimtari te ngjashëm, duke shkuar këtu se ju e keni te cekur se këto veprimtari duhet te jene sipas klasifikimit të përcaktuar nga Agjencia e Regjistrimit lë Bizneseve të Kosovës |ARBK|.). Prandaj ju NLJK keni marre parasysh qe një OE i regjistruar ne vendin e tyre te themelimit, ne rast te marrjes së tenderit dhe nënshkrimit të kontratës, janë të obliguar qe te hapin një fjal ne Republikën e Kosovës dhe te jen te regjistruar sipas kërkesave te specifikuara ne Kosove. Gjithashtu në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, ju keni theksuar se komisioni i vlerësimit te ofertave ka konstatuar se ne nuk kemi ofruar dëshminë bankare, ku është e theksuar se grupi i OE ka mjete te gatshme për ketë AP.

Ju sqarojmë se të bashkangjitur me ofertën e prezantuar ne këtë AP edhe qarkullimi bankar, ku shifet se Partneri Ynë ka mjete te mjaftueshëm ne Gjendjen e tyre le prezantuara. Andaj konsiderojmë se ky pretendim është i pa qëndrueshëm sa i përket mjeteve financiare.

Nuk pajtohemi me konstatimin e juaj pasi arsyet e eliminimit ton nuk qëndrojnë, LPP-ja qartësisht ka specifikuar se ne rast te mungese se ndonjë certifikate ose me saktë dokumentet qe nuk prodhohen nga vet operatoret ekonomik AK është i obliguar qe te kërkoj sqarim shtesë nga OE ose grupin e OE te cilët pretendon te shpërblej me kontratë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u ceken më lartë konstatojmë së ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është anuluar ky aktivitet i prokurimit, duke pasur oferta të përgjegjshme.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Nuk është respektuar neni 72 i LPP-së, Duke mos kërkuar sqarime shkresë për kompletim te dokumentacionit të nevojshëm. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1.Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatoret ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifik, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat c tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2.Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajlim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3.Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet ne mënyrë objektive.

Gjithashtu ju NUK e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe te njoftimit për kontratë , nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihte se qëllimi i juaj është që në mos të shpallmi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparentë. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP- së c parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me lë gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatës, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozitë ligjore.

Po ashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu ju keni shkelur nenin 26.5 të Rregullores 001/2022 për prokurimin Publik, ne këtë nen specifikisht është c theksuar, se OE ne rast te grupit te gjithë anëtarët duhet te dorëzojnë Certifikatat e Regjistrimit te biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga AK sipas neni 66.2, nenit 68 te LPP-se, kjo kërkesë duhet te vendoset që të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtareve individualisht të grupit. Dhe neni 26.4 të Rregullores 001/2022 për prokurimin Publik.

Gjithashtu neni 71 te PLL-së konkretisht piken 4 4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e

prokurimit sipas ncnit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtareve individual lë grupit.

Ju si autoritet kontraktues duhet lë keni në konsideratë edhe nenin I të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fundeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "NIKA PrO- Ing" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69, 71 dhe 72 te LPP-së si dhe Neni 26.4 i Rregullores nr. 001/2022 Për prokurimin publik dhe Neni 26.5 i rregullores nr. 001/2022 Për prokurimin publikNë fund kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrin: VENDIM APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e Grupi te OE nika PrO- Ing SH.P.K.; te anulohet, njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulim dhe lënda le kthehet në RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të behet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe komfor dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim:"NIKA PrO- Ing" SH.P.KPretendimi është i PABAZUAR; Autoriteti kontraktues - MKRS ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin ë tenderëve në harmoni te plotë me nenin 59 lë Ligjit nr. 04/ 1 -042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr z. 04/ L- 237, Ligjin nr. 05/ I - 068 dhe Ligjin nr. 05/ L- 092..

Kërkesa e AK - MKRS ishte: Kërkesa numër 1. Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik. Kërkesa numër 2. Operatori Ekonomik duhet t'a paraqes edhe dokumentin për regjistrim të TVSH-së. Kushtet specifike - Vetëm kategoria e Operatorëve ekonomikë Grupeve të operatoreve ekonomik me aktivitete ekonomike, sipas klasifikimit të përcaktuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës [ARBK], të përqendruar në fushën e projektimit të arkitekturës dhe in.xhinierisë si dhe të ndërtimit, janë të pranueshëm përshtatshëm për pjesëmarrje në këtë procedurë; përkatësisht, të gjitha kategoritë tjera të Operatorëve ekonomikë Grupeve të operatoreve ekonomik, nuk janë të pranueshëm përshtatshëm për pjesëmarrje dhe çfarëdo kontributi, në këtë procedurë. - Ekzekutimi i shërbimeve është i rezervuar për këtë kategori të Operatoreve ekonomik Grupeve të operatorë ekonomik në përputhje me Nenin 7- Barazia në trajtim Jo-Diskriminimi të Ligjit nr. 04 L-042 për prokurimin publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04 L-237, Ligjin Nr. 05 L-068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092.

Sa i përket pretendimit me nr. 1 të GOE ankues, AK sqaron se është tërësisht i pabazuar sepse AK ka vlerësuar duke u bazuar mbi faktet dhe argumentet e prezantuara në ofertën e ankuesit ku Anëtari/ Lideri i GOE ka prezantuar certifikatën e regjistrimit të biznesit që nuk është në përputhje me kërkesën e AK sepse aktiviteti i tyre nuk është i përqendruar në fushën e projektimit të arkitekturës dhe inxhinierisë si dhe të ndërtimit. Po ashtu, nuk ka prezantuar fare dokumentin e TVSH- së- ku për këto dokument AK mund të kërkonte informata shtesë nëse do

të ishte ofertë administrativisht e përgjegjshme.

GOE ankues nuk e ka kontestuar faktin se për ketë aktivitet të prokurimit pjesë c grupit ka qenë anëtari i cili është një kompani e regjistruar jashtë territorit të Republikës së Kosovës duke e elaboruar ecurinë dhe punën e tyre si kompani duke cituar se AK nuk ka marrë parasysh se një OE i regjistruar në vendin e tyre te themelimit në rast të marrjes dhe nënshkrimit të kontratës janë të obliguar të hapin një filiale në Republikën c Kosovës dhe të regjistrohen sipas kërkesave të specifikuara në Kosovë.

Por, pretendimet c tilla janë të pabazuara dhe janë në kundërshtim të plotë me paragrafin 3- Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofroni i informacionet do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është efiksiuir, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund te verifikohet në mënyrë objektive, i nenit 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë lë LPP- së në fuqi dhe në kundërshtim me paragrafin 38.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderi nuk mund te kërkohen, ofrohet ose lejohet, i nenit38 -Sqarimi i Tenderëve i Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik sepse në këtë fazë nuk lejohet asnjë ndryshim në aspektin e tenderit që do të ndikonte në mënyrë jo transparente dhe diskriminuese për pjesëmarrësit në këtë aktivitet të prokurimit c po ashtu sigurimi dhe plotësimi i informacionit lejohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatil për dorëzimin e tenderëve. Prandaj, ky pretendim i GOE ankues është tërësisht i pabazuar.

Pretendimi 2:Gjithashlu ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, ju keni theksuar se komisioni i vlerësimit të ofertave ka konstatuar se ne nuk kemi ofruar dëshminë bankare, ku është e theksuare se grupi i 0E ka mjete te gatshme projekt AP.

Ju sqarojmë se të bashkangjitur me ofertën e prezantuar ne ketë AP edhe qarkullimi bankar, ku shihet se partneri ynë ka ka mjete te mjaftueshme ne Gjendjen e tyre te prezantuara. Andaj konsiderojmë! Se ky pretendim është i pa qëndrueshëm sa i përket mjeteve financiar. Nuk pajtohemi me konstatimin e juaj pasi arsyet e eliminimit ton nuk qëndrojnë, LPP-ja qartësisht ka specifikuar se ne rast te mungesë se ndonjë certifikatë ose me saktë dokumentet qe nuk prodhohen nga vet operatoret ekonomik AK është i obliguar qe le kërkoj sqarime shtesë nga OE ose grupin c 012 te cilët pretendon te shpërblej me kontratë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u ceken më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nunin 59 te LPP-së, sepse është anuluar ky aktivitet i prokurimit, duke pasur oferta te përgjegjshme.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie te kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi I .1 i LPP-së.

Nuk është respektuar neni 72 i I.PP-së, Duke mos kërkuar sqarim shtesë për kompletim te dokumentacionit te nevojshëm.

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1.Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohen nga operatoret ekonomike është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifik, autoritetit kontraktuese mund të kërkojnë nga operatoret ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhc transparencës.

2.Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatoret ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3.Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Gjithashtu ju NUK c keni respektuar edhe nenin 7 të LPP, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i juaj është që ne mos

të shpallemi fitues të këtij tenderi. paragrafi 1 i nenit 7 te LPP së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik ne mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veproje në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP- së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetit kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspekte përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozitë ligjor.

Po ashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të I .LPP edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën me ekonomik, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën c prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu ju keni shkelur nenin 26.5 te Rregullores 001/2022 për prokurimin publik ne këtë nen specifikisht është e theksuar, se OE ne rast te grupit te gjithë anëtarët duhet te dorëzojnë Certifikata e regjistrimit te biznesit. Çdo kërkesë c vendosur nga AK sipas neni 66.2, nenit

Përgjigja mbi pretendimin 2 Pretendimi është i pa bazuar

Ky pretendim është tërësisht i pabazuar sepse kërkesa e AK është citat: Kërkesa 2. – Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi te gjendjes ekonomike dhe kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se disponon me kapital të mjaftueshëm për zbatimin e kontratës, qoftë mjete të gatshme në llogarinë bankare OSE qasje në një kredi hankare, të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, përkatësisht në emër të këtij aktiviteti të prokurimit, në shumën prej 600,000.00 € [Gjashtëqind mijë euro] dhe si dëshmi AK ka kërkuar si në vijim: Dëshmia e kërkuar dokumentare-Kërkesa 2.- Një [1] vërtetim nga një Bankë e kasës së parë, i cili dëshmon se

Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, disponon një mjete të gatshme në llogarinë bankare, në shumën prej 600,000.00 € [Gjashtëqind mijë euro]. [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi (lider) i Grupit, duhet të permushë së paku 60.00% të kësaj kërkese] - Një [1] kopje e origjinalit. OSE - Një [1] vërtetini nga një bankë e kasës së parë, i cili dështon se Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, disponon me qasje në një kredi bankare të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, në shumen prej 600,000.00 € [Gjashtëqind mijë euro]. [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi (lider) i Grupit, duhet të për te mbushur së paku 60.00% të kësaj kërkese] - Një [1] kopje e origjinalit ndërsa GOE ankues ka prezantuar në ofertën e tyre si dëshmi për këtë kërkesë qarkullimin bankar ashtu siç e ka potencuar edhe vetë GOE ankues në pretendimin e lartë cekur në ankesën e bërë dhe në këtë mënyrë nuk është plotësuar kërkesa e AK e paraqitur në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit

Në këtë rast, dështmia e prezantuara nga Lideri i Grupit të Operatorëve ankues nuk e plotëson kërkesën e AK- MKRS sepse Letër Referenca apo mbështetja bankare nuk e paraqet gjendjen që GOE disponon me mjete te gatshme në llogarinë bankare apo qasjen në një kredi bankare të pakushtëzuar në emër të këtij projekti por paraqet qartë se nëse subjekti në fjalë kërkon mbështetjen bankare në shumën e cikur banka do të shqyrtojë financimin c tij, bazuar në procedurat e saj të brendshme.

AK ka vlerësuar se kërkesa si c tillë nuk është përmbushur nga GOE ankues dhe në mbështetje të nenit 59 të LPP- së në fuqi si dhe neni 40 të Rregullores nr. 001 / 2022 për Prokurimin Publik AK- MKRS ka vlerësuar, ekzaminuar dhe ka ardhur në konstatim se oferta nuk është në pajtueshmëri me kërkesat formale të dosjes së tenderit dhe si e tillë oferta është vlerësuar administrativisht ofertë e papërgjegjshme dhe pretendimi i dytë i GOE ankues është në tërësi i pabazuar.

Sipas nenit 72 të LPP- së dhe nenit 38 të Rregullores nr. 00.1 /2022 për Prokurimin Publik, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokument, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektiv duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për Kontrate.

Në rastin konkret dështmitë janë prezantuar nga GOE ankues sipas kërkesës së paraqitur nga AK në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë por si të tilla nuk e plotësojnë kërkesën dhe në këtë rast nuk lejohet të kërkohen informata shtesë që do të ndryshonin aspektin e tenderit kur tashmë për AK dështmitë e paraqitura nuk e kanë përmbushur kërkesën si të tillë.

Pra, Autoriteti Kontraktues qëndron prapa arsyeve të eliminimi te të gjithë anëtareve për eliminim duke lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin për anulimin c aktivitetit të prokurimit konform dispozitës "Anulohet procedura c prokurimit duke u mbështetur në nenin 43.5 të Rregullores 001/2022, pika b, duke specifikuar: 43.5 Procedura c prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm".

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi shyrtues i Prokurimit me datë 03/12/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1166/24 dhe me datën 03/12/2024 ankesën me nr. 1167/24.

Me datë 13/12/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1166 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim te aktivitetit te prokurimit.

Ndërsa për ankesën 2024/1167 me datën 16/12/2024 është dorëzuar raporti me rekomandimi si ne vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-se për anulimin e aktivitetit te prokurimit.

Raportin e ekspertizës me nr.1166/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, pajtohet, ndërsa OE nuk ka dhen përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.1167/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues pajtohet ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertes, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "TEHNOBURIMI" D.D eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1166 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, i pakënaqur me vendimin (B58), ka dorëzuar ankese ne OSHP, me pretendimin se nuk është bere vlerësimi i ofertave konform dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurim Publik (LPP).

Eksperti shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues/MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK , pas përfundimit te vlerësimit te ofertave i ka njoftuar operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, lidhur me rezultatin e vlerësimit te ofertave. AK-MKRS, ne mungese të

ofertave te përgjegjshme e ka anuluar ne tërësi aktivitetin e prokurimit dhe njeherit operatorin ekonomik ankues (Tehno Burimi D.D), e ka njoftuar si tenderues te eliminuar me arsyetimin se:

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne ankesën e tij OE ankues, pretendon se ka ndodhur një lëshim teknik me këtë rast kërkon qe te kualifikohet si devijim i vogël sipas nenit 59.4 te LPP-se, me arsyetimin se TVSH-ja është e llogaritur brenda totalit te çmimit te ofertës, pra sipas OE ankues behet fjale vetëm për një lëshim teknik.

Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë çështje, sqaron se operatori ankues, me rastin e aplikimit ne këtë aktivitet te prokurimit e ka dorëzuar ofertën e tij, dhe ne ofertën financiare te dorëzuar ka ndërhyrë duke hequr një pjese te saj, konkretisht rubrikën e TVSH-se dhe totalit me TVSH, siç është paraqitur me larte ne tabelë.

Eksperti shqyrtues, sqaron se vlera e TVSH-se, është e llogaritur ne totalin e çmimit te dhënë, mirëpo një veprim i tille sanksionohet me nenin 44.3 te Rregullores për Prokurim Publik:

Neni 44.3: "Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header" apo kudo tjetër në dokumentet standarde".

Eksperti shqyrtues, vlerëson se operatori ekonomik ankues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 44.3 te Rregullores për Prokurim Publik, te cituar si me larte, andaj sipas dispozitës ligjore te cekur si me larte, nuk qëndron pretendimi i OE ankues se kemi dorëzuar oferte te përgjegjshme, sepse i njëjti ka ndërhyrë ne paramas duke hequr/fshirë kolona te paramases.

Lidhur me pretendimet e OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1167 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, i pakënaqur me vendimin B58 ka dorëzuar ankese ne OSHP, me pretendimin se nuk është bere vlerësimi i ofertave konform dispozitave ligjore te LPP-se.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK, pas përfundimit te vlerësimit te ofertave i ka njoftuar operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, lidhur me rezultatin e vlerësimit te ofertave. AK-MKRS-ja ne mungese te ofertave te përgjegjshme e ka anuluar ne tërësi aktivitetin e prokurimit dhe njeherit OE ankues Nika Pro ing, e ka njoftuar si tenderues te eliminuar, me arsyetimin se:

Lidhur me arsyen e pare te eliminimit, eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit shqyrtimit te ofertës se OE ankues, sqaron se OE ankues nuk ka dorëzuar dëshminë e kërkuar ne dosje te tenderit lidhur me mjetet e gatshme ose qasjen ne kredi te pakushtëzuar.

Sa i përket arsyes se dyte te eliminimit eksperti shqyrtues sqaron se AK, ka kërkuar qe veprimtaria e biznesit te jetë ne fushën e projektimit te arkitekturës dhe inxhinierisë si dhe te ndërtimit. Ndërsa OE ankues ne ankesën e tij ka dorëzuar si prova kontrata te ndërtimit te spitaleve, pishinave te hapura dhe te mbyllura duke dëshmuar se e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit te certifikatës se biznesit te operatorit ekonomik Anion MEP -Qatar, vlerëson se i njëjti nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit sepse nuk i ka veprimtarit e kërkuara nga AK ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate. Veprimtarit e OE Anion MEP – Qatar te përshkruara ne certifikatën e biznesit janë kryesisht te fushës se elektrikes.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në ketë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertes shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertes shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër,

Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatoreve ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik "TEHNOBURIMI" D.D duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – "MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK" lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA" me nr. të prokurimit: 207-24-8717-5-1-1.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertes shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertes shqyrtuese. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatoreve ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik "NIKA PrO- Ing" SH.P.K duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – "MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK" lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Pishinës Gjysmë-Olimpike, në Podujevë, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike, të miratuara nga 'World Aquatics FINA" me nr. të prokurimit: 207-24-8717-5-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- OE - **" TEHNOBURIMI " D.D., NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: